



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 17 Janar 2024

## AMICUS CURIAE

### OPINION MIQËSOR NË INTERES TË GJYKIMIT KUSHTETUES

#### MBI PROTOKOLLIN NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MIGRACIONIT

##### Hyrje

Në fillim të muajit Nëntor 2023, në media u bë publik lajmi i firmosjes së *Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit*, i cili më herët ishte i panjohur në çdo nivel të debatit publik shqiptar dhe rrjedhimisht i pakonsultuar në publik. Më 7 Nëntor 2023, ky protokoll u publikua në faqen zyrtare të institucionit të Kryeministrit.<sup>1</sup> 10 ditë më vonë, në dt.17 Nëntor, ky protokoll u depozitua për t'u miratuar në Kuvendin (Parlamentin) e Shqipërisë.

Në datën 6 Dhjetor 2023, 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kanë paraqitur në Gjykatën Kushtetuese kërkesë për kontrollin e kushtetutshmërisë së Protokollit të nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, "Për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit". Kjo kërkesë është paraqitur para ratifikimit të këtij Protokollit, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "b", të Kushtetutës. Grupi i deputetëve ka ngritur pretendime se nuk është respektuar procedura e negocimit dhe e nënshkrimit, pasi Protokollit i bashkëpunimit bën pjesë në ato kategori marrëveshesh që kërkojnë autorizimin e Presidentit, pasi prek çështje të territorit dhe të drejtave themelore, sipas nenit 121, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", të Kushtetutës.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në datën 11 dhjetor 2023, pasi mori në shqyrtim paraprak çështjen vendosi ta kalojë atë për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, më datë 13 dhjetor 2023, vlerësoi se kërkesa plotëson kriteret paraprake të pranueshmërisë dhe vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh. Bazuar në nenin 52, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shqyrtimi në seancë i çështjes pezulloi automatikisht procedurat e ratifikimit në Kuvend të Protokollit të bashkëpunimit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese<sup>2</sup>.

#### 1. Legjitimiteti i Grupit të Organizatave të Shoqërisë Civile që nënshkruajnë *Amicus Curiae*

<sup>1</sup> <https://www.kryeministria.al/newsroom/protokoll-ndermjet-qeverise-se-republikes-italiane-dhe-keshillit-te-ministrave-te-republikes-se-shqiperise-per-forcimin-e-bashkepunimit-ne-fushen-e-migracionit/>

<sup>2</sup> [https://www.gjk.gov.al/web/Njoftim\\_per\\_shtyp\\_2934\\_1-94.php](https://www.gjk.gov.al/web/Njoftim_per_shtyp_2934_1-94.php)



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Bazuar në interpretimin sistematik dhe harmonik të neneve 38/2 dhe 39/1/b e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016 dhe ligjin nr. 45/2021, organizatat nënshkruese të këtij opinioni (*Amicus Curiae*) vlerësojnë se mund të jetë një subjekt i interesuar, me interes të drejtpërdrejtë për çështjen që po shqyrtohet.

Pavarësisht së kërkues të kësaj çështje janë deputetë të Kuvendit të RSH-së, përfaqësues të forcave politike të opozitës parlamentare, **ne dëshirojmë që në krye të herës të nënvizojmë se qëndrimi jonë për këtë çështje është i pavarur, i paanshëm dhe jo politik**, dhe synon të mbrojë para Gjykatës Kushtetuese, parimet e shtetit të së drejtës dhe interesit më të lartë e të drejtave themelore të azilkërkuesve dhe refugjatëve konform Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtës ndërkombëtare dhe specifiku Konventës së Gjenevës (Konventa dhe Protokollit “Për statusin e refugjatëve”, e Kombeve të Bashkuara e vitit 1951 dhe 1967).

### 2. Mosmarrja e plotfuqisë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë

Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka nënvizuar se mosmarrja e plotfuqisë nga Presidenti i Republikës për lidhjen e marrëveshjes ose dhënien e plotfuqisë, sipas ligjit, bie ndesh edhe me nenin 7 të Kushtetutës, i cili garanton parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Ky parim shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese<sup>3</sup>.

Njëjtë si në vendimin e Gjykatës Kushtetuese për antikushtetutshmërinë e marrëveshjes detare midis Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Greqisë, ne vërejmë se mospajisja e delegacionit shqiptar me plotfuqi të rregullt nga Presidenti i Republikës në nënshkrimin e këtij protokollit (midis RSH dhe RI) ka sjellë si pasojë cenimin e kompetencës së kreut të shtetit si organi kompetent për përfaqësimin e shtetit shqiptar në marrëdhënie me jashtë. Mungesa e plotfuqisë së rregullt nga delegacioni shqiptar bie ndesh me kuadrin e brendshëm kushtetues dhe ligjor lidhur me përcaktimin e kriterëve formale për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Si rrjedhojë, kjo papajtueshmëri prek edhe thelbin e protokollit të lidhur nga shteti shqiptar, i cili, në çdo rast, duhet të shprehë vullnetin e tij në përputhje me kërkesat e legjislacionit të brendshëm<sup>4</sup>.

Si rrjedhojë, ne vlerësojmë se protokollit i nënshkruar midis RSH dhe RI është lidhur në kundërshtim me kërkesat e neneve 4, 7 dhe 92/ë të Kushtetutës.

### 3. Papajtueshmëria me Kushtetutën dhe të Drejtën Ndërkombëtare

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 131/b) të Kushtetutës, kontrollon marrëveshjet ndërkombëtare para ratifikimit nga Kuvendi lidhur me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën, duke mbajtur në konsideratë të drejtën e brendshme dhe konkretisht dispozitat e Kushtetutës,

<sup>3</sup> Vendimi nr. 15, dt. 15.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi nr.47

<sup>4</sup> Po aty, paragrafi 52.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

si akti më i lart normativ në vend, dhe në varësi të objektit të marrëveshjeve, edhe të drejtën ndërkombëtare si dhe praktikën relevante të gjykatave dhe arbitrazheve ndërkombëtare në çështje të përafërta apo të ngjashme me çështjen objekt shqyrtimi.

Në protokoll janë parashikuar dy referenca, të cilat kanë shërbyer si bazë ligjore për hartimin e tij, e më konkretisht Traktati i Miqësisë dhe Bashkëpunimit, ndërmjet Republikës Italiane dhe Republikës së Shqipërisë (1995) dhe protokollin ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, për forcimin e bashkëpunimit dypalësh në luftën kundër terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore (2017). Përpos këtyre, dy Qeveritë respektive nënshkruese të kësaj marrëveshjeje bilaterale, mbajnë në konsideratë interesin e palëve për të nxitur një bashkëpunim në rritje dypalësh në të gjithë sektorët, edhe në atë të perspektivës për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Vlen të theksohet se përkundrejt parashikimeve të Protokollit për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit, vetë Traktati i Miqësisë dhe Bashkëpunimit ku protokollin bazohet, prej nenit 1 të tij, i ka kushtuar një fokus të veçantë zhvillimit të marrëdhënieve mbi bazën e bashkëpunimit dhe respektit reciprok, konform parimeve të sovranitetit, integritetit territorial, të drejtave të barabarta, dinjitetit human dhe respektit ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Sikurse do të analizohet në vijimësi të këtij opinioni, në vlerësimin tonë protokollin nuk udhëhiqet dhe nuk i pasqyron substancialisht këto parime në përmbajtjen e dispozitave të tij.

Gjithashtu, në vlerësojmë se në funksion të marrëdhënieve shumë të mira të fqinjësisë që kanë ekzistuar midis dy shteteve, një protokoll i tillë nuk duhet që të pozicionohet dhe as të kushtëzojë në mënyrë indirekte perspektivën për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Kjo konfirmohet edhe në qëndrimin e mbajtur nga Këshilli Evropian për Refugjatët dhe Mërgimtarët (ECRE), sipas të cilit “ka përfitime të ndryshme financiare dhe diplomatike për Shqipërinë, megjithatë marrëveshja duket se varet nga përparimi i Shqipërisë në procesin e anëtarësimit, që është një politikë e udhëhequr nga Komisioni”, dhe nga asnjë prej palëve të përfshira në këtë marrëdhënie bilaterale.

Vetë Protokollin i referohet në përmbajtjen e dispozitave të tij ligjit të BE-së. Nëse marrim në konsideratë këtë fakt duhet të referohemi fillimisht në përmbajtjen e nenit 78 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFEU), i cili siguron bazën ligjore për krijimin e një Sistemi të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS), i përbërë nga pjesë të ndryshme të legjislacionit dytësor, duke përfshirë ato që rregullojnë aspektet procedurale të shqyrtimit të kërkesës për azil në pikëpamje të dhënies së një statusi uniform brenda Unionit, sikurse është Direktiva e Procedurës së Azilit (APD).

Ishulli i Lampeduzës në Itali, i kategorizuar si një hapësirë kufitare *hotspot*, është përballur në javën e III-të të Shtatorit 2023 me një fluks prej rreth 11,000 migrantësh të ardhur. Ndërkohë që në Itali kanë zbarkuar këtë vit mbi 127,000 migrantë, më shumë se sa dyfishi i të njëjtës periudhë të një viti më parë.<sup>5</sup> Nisur nga kjo emergjencë migratore, vetëm para pak kohësh se të nënshkruhej ky protokoll, Kryeministrja e vendit fqinj Italisë, znj. Meloni, në

<sup>5</sup> <https://www.theguardian.com/world/2023/sep/20/ten-years-after-tragedy-tiny-lampedusa-at-centre-of-migration-crisis-again>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

një sërë deklaratash publike ka bërë me dije se nuk do ta lejonte shndërrimin e Italisë në një kamp refugjatësh për Evropën. Kjo zgjidhje në frymën e solidaritetit ende nuk është gjetur dhe vendet e tjera të BE-së sikurse është Franca kanë forcuar kontrollin në kufirin me Italinë për të ndaluar lëvizjet e paligjshme migratore që vijnë prej Italisë.<sup>6</sup>

Sa më sipër, ne vërejmë se ky protokoll vjen në kushtet e flukseve të mëdha migratore me të cilat është përballur Italia këto vitet e fundit dhe mungesës së gatishmërisë prej shumicës së shteteve anëtare të BE-së për të ndarë barrën në përputhje me parashikimet e Traktatit të Lisbonës sipas parimit të shpërndarjes së përgjegjësisë. Por për Shqipërinë, e cila ende nuk është një vend anëtar me të drejta të plota të BE-së, ndarja e parimit të “përgjegjësisë” me Italinë, mbart premisa të larta për tkurrjen e lëvizjeve migratore dhe cenimin e të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve që synojnë apo prekin rrugët migratore të BE-së, sikurse analizohet në vijimësi.

### 3.1 Pavarësia dhe tërësia territoriale

Sipas nenit 4 të Protokollit, mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet këtyre autoriteteve dhe subjekteve, që do të akomodohen në strukturat e sipërpërmendura, i nënshtrohet ekskluzivisht juridiksionit italian (Neni 4). Ky parashikim bie ndesh me konceptin ndërkombëtar të shtetit sovran, sipas të cilit çdo shtet ka të drejtën dhe detyrimin e plotë për të zbatuar legjislacionin përkatës e unik brenda kufinjve të juridiksionit territorial. Pavarësia e shtetit shqiptar dhe tërësia e territorit të tij gjen mbrojtje në nenin 3 të Kushtetutës, ndërkohë që sipas nenit 2 të saj, sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit, i cili e ushtron atë me anë të përfaqësuesve të tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë.

### 3.2 Mungesa e Konsultimit Publik

Publikimi i protokollit pas miratimit të tij nga dy krerët e Ekzekutivit (Italian dhe Shqiptar) dhe mungesa e konsultimit paraprak në të dyja vendet, nuk është tregues pozitiv i shkallës së pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike dhe nivelit të demokratizimit në vend. Mirëqeverisja në demokraci presupozon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe të Shoqërisë Civile në jetën publike. Vlen të theksohet se angazhimi i publikut në politik bërje pasqyron standardet ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike të përshkruara në traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ku vendi ynë ka aderuar (sikurse është Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike). Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kuadër të procesit të integritimit në BE, i cili kërkon që shoqëria civile apo grupet e interesit të njihen dhe të konsiderohen në mënyrë të përshtatshme si partnerë kompetent dhe relevant në shumë reforma kyçe që po kalon vendi, apo në çështje me interes publik të veçantë. Në raportin e shqyrtimit/screening report për Shqipërinë, shpjegohet se kriteret politike të Kopenhagenit, kërkojnë që vendet candidate duhet të konsolidojnë institucionet demokratike “të qëndrueshme” përpara se të anëtarësohen në BE. Funksionimi i institucioneve demokratike kërkon një angazhim specifik të strukturuar dhe për të qenë kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës, nevojitet të zhvillohet në tre shtylla kryesore<sup>7</sup>, njëra prej të cilave është roli

<sup>6</sup> <https://cde.news/i-wont-let-italy-become-europes-refugee-camp-meloni/>

<sup>7</sup> Dy shtyllat e tjera kanë të bëjnë me: 1. procesin zgjedhor, duke përfshirë funksionimin e administratës zgjedhore, mediave në fushatën zgjedhore dhe financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore dhe, 2. funksionimi i parlamenteve në një sistem demokratik.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

i shoqërisë civile, duke përfshirë komizat ligjore, rregullatore dhe të politikave për organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), si dhe kontekstin më të gjerë për një mjedis të favorshëm<sup>8</sup>. Në raport po ashtu thuhet se konsultimi publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit mbeti formal. Ndërveprimi me OSHC-të dhe grupet e interesit po ndodh në nivel formal, edhe pse mund të intensifikohet më tej dhe të zhvillohet në shkëmbime më kuptimplote<sup>9</sup>.

### 3.3 Mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se çdo ndërhyrje duhet të jetë e ligjshme (“në shkallën e parashikuar nga ligji”, neni 8/2 i KEDNJ). Kërkesat e “ligjshmërisë” nënkuptojnë/përfshijnë kriterin e qartësisë dhe të parashikueshmërisë së ligjit. Parashikueshmëria shpreh mbrojtjen e kundër arbitraritetit si nga agjencitë e sigurisë dhe nga autoritetet mbikëqyrëse.

Në jurisprudencën e saj Gjykata jonë Kushtetuese është shprehur se vetë siguria juridike, si element i mishëruar në parimin themelor të shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës), ka si kërkesë të domosdoshme që *ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese).*

Organizatat nënshkruese të këtij Amicus Curiae vërejnë se përmbajtja e këtij protokollit reflekton një sërë paqartësish të cilat mund të rezultojnë me shkelje të natyrës potenciale dhe reale të të drejtave dhe lirive të azilkërkesve dhe refugjatëve.

Efektet e pasigurisë ligjore që vijnë nga fakti se dispozitat e protokollit janë të paqarta dhe diferencat e krijuara, janë nënvizuar si shqetësuese edhe nga Komisionerja për të Drejtat e Njeriut të Këshillit Evropian, e cila thekson se “*në praktikë, mungesa e sigurisë ligjore ka të ngjarë të dëmtojë garancitë thelbësore të të drejtave të njeriut dhe llogaridhënien për shkeljet, duke rezultuar në trajtim të ndryshëm midis atyre, kërkesat e të cilëve për azil do të shqyrtohen në Shqipëri dhe atyre për të cilët kjo do të ndodhë në Itali.*”

Sipas deklaratave në media të funksionarëve të lartë të shtetit shqiptarë, do të ngrihen dy qendra pritëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, një prej të cilave në Shëngjin dhe një tjetër në Gjadër,<sup>10</sup> pjesë e juridiksionit territorial të Bashkisë Lezhë. Referuar tekstit të Aneksit 1 të protokollit përmendet vetëm termi zonë, të kategorizuara si ‘zona e destinuar për ngritjen e strukturave për procedurat e hyrjes’ dhe ‘zona e destinuar për realizimin e strukturave për verifikimin e kushteve të njohjes së mbrojtjes ndërkombëtare dhe për riatdhesimin e migrantëve që nuk kanë të drejtë hyrjeje dhe qëndrimi në territorin italian’. Përdorimi i terminologjisë në numrin shumë ‘zonat’ mund të krijojë premisa për krijimin dhe ngritjen e të tjerave potenciale në të ardhmen. Referuar të dhënave publike Bashkia Memaliaj së fundmi i është drejtuar me një letër Kryeministrit Shqiptar, ku vetëofrohet për

<sup>8</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en)

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/marreveshja-per-emigrantet-balla-italia-do-ti-perdore-pa-shperblim-zonat-shqiptare>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të strehuar një pjesë e emigrantëve, në shenjë të mikëpritjes që migrantët shqiptarë kanë gjetur në vendet Evropiane<sup>11</sup>.

Përmbajtja e nenit 4 të Protokollit reflekton një dualizim të kompetencave midis autoriteteve përgjegjëse shqiptare dhe atyre italiane. Autoritetet kompetente shqiptare duhet të lejojnë hyrjen dhe qëndrimin në territorin shqiptar të migrantëve të strehuar në këto struktura, mbetet e paqartë se si do të garantohet respektimi i detyrimeve kryesore nga ana e autoriteteve kompetente italiane.

Ndërkohë që zonat e përcaktuara në protokoll<sup>12</sup> janë prona të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, e nisur nga fakti se strukturat do të ndërtohen dhe do të menaxhohen, në përputhje me legjislacionin përkatës italian, pa pasur nevojë për leje ndërtimi apo formalitete të tjera të ngjashme, të kërkuara nga legjislacioni shqiptar (neni 5), ne vërejmë se shteti nuk garanton administrimin e pronës së paluajtshme në përputhje me nenin 12 të ligjit nr. 8743/2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i përditësuar. Rrjedhimisht, cenohet parimi kushtetues i garantuar në paragrafin e 1 të nenit 4 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

Ne vlerësojmë se protokollin është i paqartë se si do të trajtohen rastet e shkeljeve potenciale të të drejtave të këtyre migrantëve nga punonjësit e institucioneve shqiptare të vendosur në shërbim të kampit. Në këto raste, palët mund të gjenden përballë zbatimit të legjislacionit shqiptar, i cili pashmangshmërisht nuk është në pajtim të plotë me legjislacionin e BE-së e rrjedhimisht nuk i përmbahet praktikave më të mira evropiane.

Gjithashtu, është e paqartë hapësira e zbatimit të legjislacionit shqiptar, në rast se shtetasit që dalin në mënyrë të paautorizuar nga strukturat e ndërtuara mbi zonat përkatëse, dhe më tej cenojnë rendin dhe sigurinë publike apo të drejtat e shtetasve të tjerë shqiptarë nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të tyre të kundërligjshme. Po në këtë rast, autoritetet vendase do të procedojnë nëpërmjet shoqërimit të shtetasve të huaj pranë strukturave tek të cilat ato qëndrojnë, apo do të vijohet me kufizimin e lirisë së tyre pranë institucioneve ligj zbatuese e akomoduese të mbyllura shqiptare?! Fakti që Protokollin (neni 6.8.) parashikon përjashtimin nga sekuestrimi ose masa të tjera të ngjashme në kuadrin ligjor shqiptar, ndaj dokumenteve zyrtare të mbajtura në çfarëdolloj cilësie nga autoritetet italiane dhe nga personeli italian, ngre pikëpyetje për zbatueshmërinë e legjislacionit shqiptar. Por edhe në rast se ky i fundit zbatohet, është e paqartë se çfarë ndodh me procedurën e azilit ndaj shtetasve në fjalë.

Aspekte të rëndësishme të lidhura me paqartësinë e këtij protokollin, vendosin në pikëpyetje serioze të drejtat dhe liritë e garantuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sikurse do të anlaizohet në seksionin në vijim.

### **3.4 Cenimi i standarteve ndërkombëtare në fushën e azilit dhe të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut**

<sup>11</sup> Marrëveshja Shqipëri-Itali, bashkia e Memaliajt vetë ofrohet për strehimin e refugjatëve ilegalë - [Albeu.com](http://Albeu.com)

<sup>12</sup> Zona e destinuar për ngritjen e strukturave për procedurat e hyrjes’ dhe ‘zona e destinuar për realizimin e strukturave për verifikimin e kushteve të njohjes së mbrojtjes ndërkombëtare dhe për riatdhësimin e migrantëve që nuk kanë të drejtë hyrjeje dhe qëndrimi në territorin italian’



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Skema e flukseve migratore që kanë prekur shtetin fqinjë, Italinë, synohet të menaxhohet sipas Protokollit duke bërë të mundur dërgimin dhe shoqërimin në vendin tonë të atyre “Migrantëve”, shtetas të vendeve të treta dhe ata pa shtetësi për të cilët duhet vërtetuar apo është vërtetuar ekzistenca e kushteve për hyrje, qëndrim ose banim në territorin Italian, akomodimin e tyre në strukturat e ndërtuara në zonat e përcaktuara në territorin shqiptar, të cilat do të menaxhohen nga shteti Italian, kryerjen ndaj tyre të procedurave kufitare apo të riatdhesimit, të parashikuara nga legjislacioni italian e evropian dhe për kohën rreptësisht të nevojshme për të, teksa ata ndodhen fizikisht në këto struktura të ndërtuara në territorin shqiptar.

Autoritetet shqiptare e justifikojnë këtë protokoll me mikëpritjen që Italia ka treguar ndaj shtetasve shqiptarë përgjatë viteve të vështira të emigrimit pas rënies së regjimit totalitar e duke u bazuar në frymën e bashkëpunimit, mikpritjes dhe integritetit që shteti dhe populli italian kanë dëshmuar ndër vite ndaj qindra mijëra migrantëve shqiptarë. Nëse ky qëllim do të ishte i vërtetë, kontradikta që lind është se si mundet që Shqipëria me një sipërfaqe 10fish më të vogël se Italia, të ketë më shumë hapësirë se kjo e fundit për ndërtimin e qendrave (strukturave) pritëse të migrantëve që vijnë nga Afrika? Qartazi qëllimi i vërtetë i marrëveshjes është të tkurrë lëvizjet migratore drejt Italisë dhe kjo nuk reflekton mikëpritjen italiane ndaj shtetasve shqiptarë që kanë zgjedhur të migrojnë në Itali, edhe për argumentat që do të parashtrihen në vijimësi.

Shtetasit e vendeve të treta që vijnë nga Afrika dhe kapen në Itali do të akomodohen në Shqipëri, në zonat (strukturat) në përdorim të shtetit Italian, të cilat i nënshtrohen regjimit të sigurisë në dy nivele (brenda zonave përgjegjës për ruajtjen dhe rendin do jenë autoritetet italiane ndërkohë që në perimetrin e jashtëm përgjegjësia do jetë e autoriteteve shqiptare.

Referuar nenit 6, pika 5 të protokollit, autoritetet italiane do të marrin masat e nevojshme për të siguruar qëndrimin e migrantëve brenda zonave, duke mos lejuar daljen e paautorizuar të tyre në pjesën tjetër të territorit të Republikës së Shqipërisë, si gjatë kohëzgjatjes së procedurave administrative ashtu edhe në përfundim të tyre. Pra migrantët që do të qëndrojnë në këto zona do t'i nënshtrohen kufizimit të lirisë si dhe një “paraburgimi” të mirfilltë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 38 të Kushtetutës Shqiptare dhe nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe nenit 2 të Protokollit nr.4 të saj, të cilat garantojnë lirinë e lëvizjes si dhe të drejtën për liri dhe siguri. Ndaj këto qendra nuk mund të jenë mikëpritëse, por ato janë kampe të mirëfillta migrantësh dhe refugjatësh. Duke qenë se Shqipëria, për këta shtetas nuk është as vend tranzit dhe as vend origjine, efektet që do të sjellë ky protokoll në vlerësimin tonë do të jenë tkurrëse ndaj lëvizjeve migratore si dhe mund të sjellë ndryshime të rrugëve migratore për kontrabandistët që i ndihmojnë ata, për të arritur me çdo kusht vendet e BE-së, duke vendosur në rrezik jetën e shëndetin e tyre. Vendi ynë, si pjesë e rrugës së njohur migratore të Ballkanit Perëndimor<sup>13</sup> nuk ofron garanci të mjaftueshme për të qenë i sigurtë, pasi në shumë raste migrantët nga vendet e treta kanë rënë preh e grupeve kriminale të kontrabandistëve, që i kanë kaluar në mënyrë të paligjshme dhe në disa raste të rrezikshme për jetën e shëndetin, drejt vendeve të BE-së. Gjithashtu, mbetet e paqartë se cilat do të jenë kushtet që do të legjitimojnë autorizimin e këtyre migrantëve për

<sup>13</sup> Western Balkan Route



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të dalë nga struktura, nëse do të jenë autoritetet italiane, shqiptare apo të dyja, sa kohë që do të ketë dy perimetra sigurie të administruar përkatësisht nga secila palë.

Ekspertët pranë *Amnesty International* deklarojnë se kjo marrëveshje bilaterale implikon cenimin e parimit të “moskthimit”, i cili mbrohet nga ligji ndërkombëtar dhe evropian dhe për të cilën Italia është penalizuar më herët nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut<sup>14</sup>. Parimi i mos-kthimit mbrohet në nenin 78(1) TFEU dhe nenin 18 dhe 19 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

Komisionerja e lartë për të drejtat e njeriut në *Këshillin e Evropës, Dunja Mijatović*, deklaroi se “masat e propozuara në protokoll rrisin në mënyrë të ndejshme rrezikun për të ekspozuar refugjatët, azilkërkuesit dhe emigrantët ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Bartja e përgjegjësisë përtej kufijve nga disa shtete stimulon shtetet e tjera që të veprojnë njësojë, gjë që rrezikon që të krijojë një efekt domino që të do minonte sistemin evropian dhe botëror për mbrojtje ndërkombëtare”<sup>15</sup>.

Duke patur në konsideratë shqetësimet e këtyre organizatave ndërkombëtare, si dhe në kushtet e distancës që ekziston ndërmjet dy vendeve dhe parimit të sovranitetit që vepron mbi secilin prej tyre, ne evidentojmë rrezikun potencial të mosgarantimit, përkatësisht nga pala italiane dhe shqiptare, të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Gjenevës, sa i takon parimit të moskthimit dhe parimit të aksesit të menjëhershëm në drejtësi që migrantët duhet të kenë në rast refuzimi të kërkesave të tyre.

Në qëndrimin e saj paraprak UNHCR ka nënvizuar se “*Sipas ligjit ndërkombëtar për refugjatët, përgjegjësia kryesore për vlerësimin e kërkesave për azil dhe dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare i takon shtetit në të cilin një azilkërkues arrin, qoftë në kufijtë tokësorë apo në det, dhe e kërkon atë mbrojtje. Ky detyrim mbetet i pandryshuar nga transferimi i azilkërkuesve apo përpunimi jashtë-territorial. Ndërsa marrëveshjet e transferimit ligjor për bashkëpunimin për azilin mund të bëhen ndërmjet shteteve, masa të tilla duhet të sigurojnë dhe përmirësojnë mbrojtjen e refugjatëve.*”<sup>16</sup>

Sipas nenit 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut të parashikuar në këtë akt themeltar të legjislationit shqiptar nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në vlerësimin e respektimit të kufizimeve të parashikuara në KEDNJ, referencë e rëndësishme janë vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Në rastin e Italisë, GJEDNJ ka konstatuar shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të njeriut, në lidhje me modalitetet e ndalimit në ato që quhen Hot Spotet ku mbahen migrantët në shtetin fqinjë. Situata aktuale në Hot Spotet Italiane nuk tregon për një praktikë pozitive, e cila do të çojë më pas edhe Shqipërinë në krijimin e mosmarrëveshjeve para GJEDNJ-së, e cila ka konstatuar tashmë shkeljen e neneve 3 (ndalimi i Torturës) dhe neneve 5 (e drejta për liri dhe siguri), për shkak të

<sup>14</sup> Hirsi Jamaa and Others v. Italy (2012, ECHR)

<sup>15</sup> Marrëveshja Itali-Shqipëri rrit më shumë tendencën shqetësuese evropiane drejt trajtimit nga jashtë të procedurave të azilit - Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë (coe.int)

<sup>16</sup> <https://www.unhcr.org/news/press-releases/unhcr-transfer-arrangements-asylum-seekers-and-refugees-must-respect>





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mungesës së një baze të qartë ligjore për ndalimin dhe kushtet ekzistuese në qendrat Hotspot në Itali. Kjo paqartësi reflektohet edhe në tekstin e protokollit të nënshkruar me Shqipërinë<sup>17</sup>. Vlen të theksohet se megjithëse menaxhimi i strukturave pritëse që do të ndërtohen në territorin shqiptar i atribuohet nga Protokollit autoriteteve italiane, fakti që ato ndodhen në Shqipëri do t'i bënte autoritetet shqiptare potencialisht (corresponsabili) përgjegjëse për të njëjtat shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohen autoriteteve italiane. Në këtë kuptim, në shumë raste GJEDNJ-ja ka dënuar autoritetet e një shteti për transferim në një shtet tjetër, sepse ata ishin në dënim të situatës në shtetin tjetër ose dënonin autoritetet e një shteti<sup>18</sup>.

Një aspekt tjetër interesant nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ ka të bëjë me modalitetet e transferimit të migrantëve në Shqipëri. Ky aspekt është shumë i paqartë dhe i mjegullt në tekstin e protokollit dhe mund të çojë në shkelje të pastra të nenit 3 (ndalimi i torturës) dhe 5 (e drejta për liri dhe siguri) KEDNJ, sikurse është shprehur së fundmi kjo gjykatë në një vendim në lidhje me Italinë dhe modalitetet e transferimit të emigrantëve. Protokollit nuk sqaron mjaftueshëm se si do të transferohen emigrantët në strukturat pritëse të ndërtuara në zonat e territorit shqiptar, pas operacioneve të shpëtimit dhe si do të transferohen jashtë territorit shqiptar në përfundim të qëndrimit të tyre në këto zona. Rrjedhimisht, procedurat e kapjes, transferimit dhe ndalimit të tyre mund të përbëjnë shkelje të neneve 3 dhe 5 të KEDNJ<sup>19</sup>.

Protokollit nuk ofron garanci të mjaftueshme në lidhje me mostransferimin e personave që i përkasin grupeve në nevojë dhe në veçanti të të miturve në qendra. Duke pasur parasysh sanksionet që GJEDNJ ka dhënë ndaj Italisë, për ndalimin e të miturve të pashoqëruar në qendrat e pritjes italiane, edhe për shkak të identifikimit të tyre si të rritur, rreziku që të miturit dhe personat vulnerabël të mbahen në strukturat pritëse të ngritura në territorin shqiptar është shumë i lartë<sup>20</sup>.

Përtej garancive që palët kanë artikulluar në daljet e tyre publike, strukturat italiane përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave të migrantëve, në kushtet e transferimit dhe veprimet të tyre në një shtet sovran siç është Shqipëria, pavarësisht se këto zona janë nën autoritetin italian nuk mund të veprojnë në të njëjtat kushte sa i takon garancive të së drejtës për një proces të rregullt, sikurse do të veprojnë me migrantët që ndodhen fizikisht në territorin Italian.

Ne vërejmë se procedura e ankimit ndaj vendimmarrjeve refuzuese të autoriteteve italiane, mbetet e paqartë nga përmbajtja e dispozitave të Protokollit, nëse do të realizohet nëpërmjet video-konferencës, apo përdorimit të mjeteve të rrugëve elektronike (*remotely*). Në çdo rast, veprimi në distancë vendos në pikëpyetje parime të rëndësishme të funksionimit të shtetit të së drejtës si dhe standartet e të drejtës për proces të rregullt të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht dobësohet kontrolli i ushtruar nga

<sup>17</sup> CASE OF J.A. AND OTHERS v. ITALY - Application no. 21329/18; CASE OF A.S. v. ITALY - Application no. 20860/20; CASE OF A.B. v. ITALY - Application no. 13755/18; CASE OF A.S. v. ITALY (Application no. 20860/20)

<sup>18</sup> MSS v. BELGIUM AND GREECE - application n. 30696/09 and TARAKHEL v. SWITZERLAND - application n. 29217/12

<sup>19</sup> CASE OF A.E. AND OTHERS v. ITALY - Applications n. 18911/17 and 2 others

<sup>20</sup> Darboe Camara, M.A. v. Italy - Application 5797/17, A. T. and others v. Italy - Application no. 47287/17



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

autoritetet italiane në kontakt me emigrantët në këto zona, si nga organet e prokurorisë ashtu edhe nga organet gjyqësore, duke krijuar një barrë të vështirë provash për migrantët për shkeljet e mundshme si dhe në trajtimin e kërkesave të migrantëve. Në këtë kushte krijohen premisa potenciale për cenimin e aksesit të tyre efektiv në procedurat e azilit dhe sistemin e drejtësisë.

Garantimi i të drejtës për t'u mbrojtur, si një element i rëndësishëm i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 9.2 të Protokollit konsiderohet se do të ofrohet nëpërmjet krijimit të aksesit në struktura të avokatëve, ndihmësve të tyre si edhe të organizmave ndërkombëtarë dhe agjencive të Bashkimit Evropian që ofrojnë këshilla dhe asistencë për azilkërkuuesit, ndërkohë që një parashikim i ngjashëm mungon për organizatat jofitimprurëse Italiane dhe Shqiptare që ofrojnë shërbime ligjore falas për këtë kategori. Në pikëpyetje vendoset gjithashtu efektiviteti i mbrojtjes sa kohë për avokatët italianë do të jetë e vështirë prezenca e tyre fizike ndaj shkeljeve potenciale me të cilat mund të përballën këta shtetas, si në procedurën e azilit por edhe në raport me trajtimin dhe kushtet e tyre në strukturat akomoduese.

Bazuar në argumentat e mësipërme, ne vlerësojmë se protokollin nuk ofron garanci të mjaftueshme në lidhje me respektimin e plotë të së drejtës së mbrojtjes (sipas nenit 6 të KEDNJ) dhe të drejtës për një mjet juridik efektiv, duke rezultuar me shkeljen e mundshme të nenit 13 të KEDNJ-së veçanërisht në lidhje me nenet 3 (ndalimi i torturës), 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, duke marrë si referencë, vendimet e GJEDNJ ndaj Italisë të evidentuara në footnotes të këtij seksioni.

#### 4. Implikimet e Legjislacionit të BE-së

Sipas vlerësimit paraprak që i përket zhvillimeve të fundit të Komisionit Evropian pasi është njohur me protokollin, Shtetet Anëtare kanë të drejtë të shtrijnë juridiksionin e tyre në vende të tjera.<sup>21</sup>

Por në vitin 2018, KE ka patur një qëndrim krejtësisht të kundërt. Në dokumentin që vlerëson fizibilitetin ligjor dhe praktik të opsioneve të zbkimit, KE shprehet kundër skenarit 3 që ka të bëjë me përpunimin e jashtëm të kërkesave për azil dhe/ose procedurave të kthimit në një vend të tretë. Sipas KE-së, dërgimi i një azilkërkuesi në një vend të tretë pa përpunuar kërkesën e tij për azil në vendin e BE-së përbën rikthim që nuk lejohet sipas ligjit të BE-së dhe ndërkombëtare. Për të lejuar individët të "aplikojnë" për azil jashtë BE-së do të kërkonte zbatimin ekstra territorial të ligjit të BE-së, i cili aktualisht nuk është as i mundur dhe as i dëshirueshëm. E vetmja mënyrë për të funksionuar kjo do të ishte krijimi i sistemit të azilit të BE-së dhe gjykatave të BE-së për të përpunuar kërkesat e shoqëruar nga një strukturë apelimi në nivel BE. Përveç nevojës për një transformim të madh institucional, ky skenar do të kërkonte burime të konsiderueshme në dispozicion të gjykatave dhe organeve të reja të BE-së për azil. Ne vërejmë se një reformim dhe infrastrukturë e tillë, nuk rezulton në praktikë të jetë garantuar 5 vite më pas, në kohën kur ky protokoll është nënshkruar nga Kryeministri Shqiptar dhe Kryeministrja Italiane.

<sup>21</sup> <https://www.brusselstimes.com/eu-affairs/815560/migration-deal-physically-in-albania-legally-in-italy>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Modeli i prezantuar me anë të protokollit për administrimin ekstra-territorial të migracionit nga Qeveria Italiane duke ndërtuar struktura akomoduese në territorin shqiptar, ngjan me modelin australian, i ashtuquajtur “Politika e Australisë në det të hapur”. Koncepti i eksternalizimit të procedurave të migracionit mbetet një çështje e debatueshme. Në praktikën e BE-së janë vërejtur dy lloje kategorizimesh të masave që janë ndërmarrë nga ana e shteteve anëtare të cilat janë përballur me emergjenca të flukseve migratore. Më konkretisht, në kategorinë e parë, përfshihen shtetet të cilat kanë dhënë përgjegjësinë e menaxhimit të kufirit tek vendet e treta, si Libia dhe Maroku, nëpërmjet asistencës financiare dhe teknike, në mënyrë që t’u mundësojnë atyre të parandalojnë largimet. Ndërkohë, në kategorinë e dytë përfshihen vendet të cilat kanë përdorur konceptin e vendit të tretë të sigurt ose vendit të parë të azilit dhe vendit të sigurt të origjinës në Direktivën e Procedurës së Azilit (APD) për të deklaruar kërkesat për azil të papranueshme pa vlerësuar meritën e aplikimit të tyre ose t’i shqyrtojë ato në bazë të një procedure të përshpejtuar pas një vlerësimi individual për t’i lejuar aplikantit të kundërshtojë supozimin e sigurisë. Shembuj të dukshëm lidhen me deklaratën BE-Turqi dhe Memorandumin e Mirëkuptimit BE-Tunizi, ku Turqia u zotua të ripranonte azilkërkuessit sipas zbatimit të konceptit të vendit të tretë të sigurt dhe Tunizia u zotua të ripranonte shtetasit e saj sipas konceptit të vendit të sigurt të origjinës.<sup>22</sup>

Në shumicën e rasteve, situatat e monitoruara në këto qendra pritëse e me kapacitete akomoduese kanë treguar se *“ka pasur abuzime fizike, mendore dhe seksuale të dokumentuara gjerësisht kundër burrave, grave dhe fëmijëve. Hetimet e Senatit kanë gjetur se kushtet në qendrat e përpunimit janë jo adekuate, të papërshtatshme ose të pasigurta për azilkërkuessit e ndaluar atje’ me disa raste abuzimi, vetë-lëndimi dhe neglizhimi”*.<sup>23</sup> Njëjtë me këtë praktikë më herët të analizuar dhe monitoruar nga aktorët ndërkombëtarë, Italia dhe BE kanë një marrëveshje të ngjashme edhe me Libinë. Refugjatët e vendosur në strukturat e ngritura për këtë qëllim në Libi, kanë dëshmuar abuzime të ndryshme të drejtave të njeriut, duke përfshirë përdorimin e dhunës fizike, torturës dhe përdhunimeve. Të tjerë kanë raportuar edhe prezencë të vrasjeve brenda kampeve, ndërkohë që të akomoduarit janë shprehur për median prestigjioze ‘The Guardian’ se migrantët po vdesin nga sëmundjet dhe uria.<sup>24</sup>

Në përgjithësi, ne besojmë gjithashtu se mund të jetë e rëndësishme të theksohet se si Protokollit mund të ketë implikime në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE për këto arsye:

Së pari, vlerësimi i procesit të anëtarësimit përfshin si parakusht respektimin e plotë të të drejtave të parashikuara nga KEDNJ dhe gjithashtu të parimeve të përcaktuara në jurisprudencën e KEDNJ. Protokollit krijon premisa reale për mosrespektimin e tyre, sikurse janë argumentuar më herët në këtë dokument.

Së dyti, kur Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, do të duhet të sigurojë zbatimin e plotë të ligjit të BE-së dhe jo vetëm zbatimin e pjesshëm. Prandaj, çdo

<sup>22</sup> <http://www.sidiblog.org/2023/11/15/on-the-incompatibility-of-the-italy-albania-protocol-with-eu-asylum-law/>

<sup>23</sup> <https://academic.oup.com/jrs/article/36/2/271/7081292>

<sup>24</sup> <https://www.theguardian.com/world/2018/may/08/italy-deal-with-libya-pull-back-migrants-faces-legal-challenge-human-rights-violations>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

paligjshmëri/papajtueshmëri me ligjin e BE-së që rrjedh nga Protokolli (ligji i BE-së për azilin dhe kthimin) mund të ketë pasoja edhe në këtë nivel.

Së fundi, përveç referencave në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut dhe papajtueshmëria me ligjin e BE-së, mund të ngrihen gjithashtu para Gjykatës së Drejtësisë së BE-së (GJED), e cila mund të konsiderohet kompetente për shkak të shtrirjes nga ana e Italisë të zbatimit (edhe vetëm indirekt) të ligjit të BE-së jashtë territorit të saj.

**Në përfundim**, ne kërkojmë që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë me kujdesin e duhur të gjitha argumentat e paraqitura në këtë Amicus Curiae, duke kërkuar që ky protokoll të deklarohet në kundërshtim me Kushtetutën Shqiptare, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencën e GJEDNJ-së, Konventën e Gjenevës për Azilin dhe të drejtën ndërkombëtare në tërësi.

### **Organizatat nënshkruese mbështetëse (të renditura sipas rendit alfabetik):**

1. **A Buon Diritto Onlus APS, Itali**
2. **ARCI APS, Itali**
3. **Associazione per gli Studi Giuridici sull'Immigrazione**
4. **Civil Rights Defenders, Zyra në Shqipëri**
5. **Drejtësi Sociale**
6. **Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF)**
7. **Grupa 484**
8. **Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut (GSHDNJ)**
9. **Helsinki Committee for Human Rights in Serbia**
10. **Helsinki Committee for Human Rights, North Macedonia**
11. **Hrvatski Pravni Center, Kroaci**
12. **Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)**
13. **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**
14. **Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome**
15. **Macedonian Young Lawyers Association**
16. **Programi për të Drejtat Civile Kosovë**
17. **Qendra "A.L.T.R.I"**
18. **Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC)**
19. **Qendra Europiane**
20. **Qendra H.A.N.A (Hand to Hand Against Nation Apathy)**
21. **Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare (NCCS)**
22. **Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës**
23. **Qendra për Drejtësi Gjinore**
24. **Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes**
25. **Qendra Psikosociale "Vatra"**
26. **Roma Versitas Albania**
27. **Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)**



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

28. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)
29. Shoqata Multifunktionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim (MKEZH)
30. Vasa Prava BiH, Bosnia dhe Hercegovina
31. YMCA Albania